

Shkollat Publike të Qytetit të Nju Jorkut Ligji Vendor 12 (New York City Public Schools Local Law 12) Raporti i Progresit për Qasjen 2024–2025

Tabela e Përmbajtjes

E Përgjithshme	2
Plani i Qasjes dhe Raporti i Progresit.....	2
Deklaratë Angazhimi	3
Lehtësuesi për Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Informacione të Tjera Kyçe për Qasjen.....	3
Procesi i Komenteve (Feedback Process)	3
Qasja Fizike.....	4
Zhvillime që nga Prilli 2024.....	4
Qëllimet deri në Maj 2026.....	5
Qasje Dixhitale	5
Zhvillime që nga Prilli 2024.....	5
Qëllimet deri në Maj 2026.....	6
Qasje Programore	6
Zhvillime që nga Prilli 2024.....	6
Qëllimet deri në Maj 2026.....	8
Komunikimi Efektiv	8
Zhvillime që nga Prilli 2024.....	8
Qëllimet deri në Maj 2026.....	9
Përfshirja në Vendin e Punës	9
Zhvillime që nga Prilli 2024.....	9
Qëllimet deri në Maj 2026.....	10
Konsultime dhe Komente nga Publiku	10
Përfundime	11

E Përgjithshme

Misioni i Shkollave Publike të Qytetit të Nju Jorkut (NYCPS) është të sigurojë që çdo nxënës të diplomohet duke ndjekur një rrugë drejt një karriere shpërblyese dhe sigurie ekonomike afatgjatë, i/e përgatitur për të qenë një forcë pozitive për ndryshim. Me një popullsi totale prej afërsisht 900,000, nxënësish, Shkollat Publike të Qytetit të Nju Jorkut (NYCPS) përbëjnë sistemin shkollor më të madh në vend. Promovimi i suksesit të nxënësve kërkon bashkëpunim ndërmjet divizioneve (dikastereve) dhe zyrave të ndryshme brenda agjencisë për të mbështetur mbi 1,800 shkolla dhe programe. Duke pasur parasysh nevojat e ndryshme të popullsisë së saj të nxënësve, NYCPS ka krijuar një rrjet gjithëpërfshirës strukturash dhe sistemesh për të mbështetur të gjithë nxënësit, përfshirë ata me aftësi të kufizuara.

Plani i Qasjes dhe Raporti i Progresit

Në përputhje me Ligjin Vendor 12 të Qytetit të Nju Jorkut të vitit 2023, dhe në konsultim me Zyrën e Kryetarit të Bashkisë për Personat me Aftësi të Kufizuara (Mayor's Office for People with Disabilities – MOPD), NYCPS hartoi një plan pesëvjeçar për qasje për vitet 2024–2028, i cili u publikua në mars 2024. Në zbatim të mëtejshëm të Ligjit Vendor 12 të Qytetit të Nju Jorkut të vitit 2023, ky raport përfaqëson raportin e parë vjetor të progresit nga ana e NYCPS. Gjatë vitit të kaluar, NYCPS ka bërë përparim të dukshëm në përmirësimin e qasjes, përfshirë projekte në vazhdim për të përmirësuar qasjen fizike, dixhitale, programore, dhe komunikimin efektiv për personat me aftësi të kufizuara. NYCPS mbetet e përkushtuar në zgjerimin e qasjes dhe përfshirjes së individëve me aftësi të kufizuara edhe në vitet në vijim.

Zyra për Planifikimin e Qasjes (Office of Accessibility Planning – OAP) është përgjegjëse për përgatitjen e këtij raporti të progresit në përputhje me Ligjin Vendor 12 të Qytetit të Nju Jorkut të vitit 2023.

Deklaratë Angazhimi

NYCPS janë të përkushtuara të sigurojnë që programet, shërbimet dhe aktivitetet e tyre të jenë të qasshme për nxënësit, anëtarët e komunitetit shkollor, stafin dhe anëtarët e familjes. Për më tepër, NYCPS synon të krijojë një proces transparent për individët që duan të kuptojnë nivelin e qasjes në shkollat dhe ndërtesat e saj, si dhe të kërkojnë përshtatje të arsyeshme.

Lehtësuesi për Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Informacione të Tjera Kyçe për Qasjen

- Lehtësuesi për Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara:
Thomas Taratko, Shef Ekzekutiv
Menaxhimi i Hapësirave (Space Management)
131 Livingston Street, Room 209, Brooklyn, NY 11201
Numri i Telefonit: (718) 935-2959
Adresë E-maili: accessibility@schools.nyc.gov
- Për informacion mbi qasjen në ndërtesat shkollore, ju lutemi vizitoni: [Qasja në Ndërtesa](#)
- Për informacion mbi Rregulloren e NYCPS kundër diskriminimit dhe procedurat për paraqitjen e ankesave të brendshme për diskriminim, ju lutemi vizitoni: [Rregullorja Kundër Diskriminimit dhe Procedurat për Paraqitjen e Ankesave të Brendshme \(Anti-discrimination Policy and Procedures for Filing Internal Complaints of Discrimination\)](#)

Procesi i Komenteve (Feedback Process)

Komente dhe sugjerime janë të mirëpritura lidhur me planin pesëvjeçar të NYCPS për qasjen 2024–2028 si dhe për këtë raport progresi.

Ju lutemi dërgoni me email në LocalLaw12@schools.nyc.gov çdo koment apo sugjerim që mund të keni.

Qasja Fizike

Përparimi në ndërtimet kapitale është një pjesë thelbësore e angazhimit të NYCPS për të vazhduar përmirësimin e qasjes në të gjitha ndërtesat e saj. Planit kapital i NYCPS për vitet fiskale 2025–2029 parashikon \$800 milionë dollarë për projekte kapitale që lidhen me qasjen. Ky investim dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm të NYCPS për të përmirësuar qasjen në ndërtesat shkollore, në mbështetje të nevojave të ndryshme të nxënësve, stafit dhe vizitorëve.

Zhvillime që nga Prilli 2024

- Në bashkëpunim me organizatat që avokojnë (mbrojnë) të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, NYCPS ka vendosur qëllimet e mëposhtme për ndërtimet kapitale në kuadër të planit kapital 2025–2029:
 - Përzgjedhja e projekteve të planit kapital për të siguruar që përqindja e ndërtesave parësore plotësisht të qasshme në të gjitha distriktet shkollore të rritet nga 33% në 40% pas përfundimit.
 - Përzgjedhja e projekteve të planit kapital për të siguruar që 75% e ndërtesave të Distriktit 75 të jenë pjesërisht ose plotësisht të qasshme, dhe që 50% e ndërtesave të Distriktit 75 të jenë plotësisht të qasshme në çdo distrikt shkollor pas përfundimit.
- Nënkomiteti për Qasje (Accessibility Sub-Committee – ASC), në mbështetje të dy objektivave të përmendura më sipër për planin kapital 2025–2029, zgjodhi gjashtë projekte për të kaluar ndërtesa jo të qasshme në ndërtesa plotësisht të qasshme, dhe tre projekte për të kaluar ndërtesa pjesërisht të qasshme në ndërtesa plotësisht të qasshme.
- Zyra për Planifikimin e Qasjes (OAP) kreu inspektime të ndërtesave dhe përgatiti mbi 200 profile të qasjes në ndërtesa (Building Accessibility Profiles – BAPs), përfshirë afërsisht 50 BAPs profile për ambiente dytësore (si anekse ose ndërtesa të përkohshme klasash).

Qëllimet deri në Maj 2026

- Në partneritet me Nënkomitetin për Qasje (Accessibility Sub-Committee – ASC), NYCPS do të miratojë projekte të tjera në mënyrë që të caktohet të paktën 50% e fondeve totale të planit kapital 2025–2029 për përparimin e qasjes në ndërtesat shkollore.
- Zyra për Planifikimin e Qasjes (OAP) do të kryejë anketime të profileve të qasjes në ndërtesa (BAP) për rreth 50% të ndërtesave parësore që aktualisht nuk janë të qasshme në të gjitha distriktet shkollore. Këto anketime BAP do të ndihmojnë në hartimin e ndërhyrjeve të ardhshme për përmirësim.

Qasje Dixhitale

NYCPS është e përkushtuar të sigurojë që përmbajtja e saj dixhitale të jetë e qasshme për individët me aftësi të kufizuara dhe të përmirësojë vazhdimisht përvojën e përdoruesit për të gjithë, duke zbatuar standardet përkatëse të qasjes.

Zhvillime që nga Prilli 2024

- NYCPS siguroi me sukses që të gjithë redaktorët e faqeve kryesore të NYCPS internetit (schools.nyc.gov dhe infohub.nyced.org) të përfundonin trajnimin e detyrueshëm për qasje dixhitale përpara se të merrnin leje për të përditësuar përmbajtjen.
- NYCPS krijoi një pozicion të ri: Specialist për Qasje Dixhitale, për të siguruar që të gjitha komunikimet publike të NYCPS, përfshirë edhe materialet për familjet, të jenë në përputhje me standardet e qasjes.
- Në korrik 2024, Divizioni i Teknologjisë Arsimore dhe Informacionit (DIIT) publikoi një udhëzues dixhital (Accessibility Development Guide) për t'u ardhur në ndihmë zhvilluesve të softuerit në mbarë NYCPS që të krijojnë programe të qasshme.
- DIIT bashkëpunoi me Zyrën e Kryetarit të Bashkisë për Personat me Aftësi të Kufizuara (MOPD) për të realizuar testime përdoruesish mbi qasjen në platformat kryesore të NYCPS.

Qëllimet deri në Maj 2026

- DIIT do të përmirësojë qasjen dixhitale duke mbështetur zhvilluesit përmes krijimit dhe publikimit të një serie kursesh trajnimi online për qasjen, ndjekjes së progresit dhe ofrimit të mbështetjes në të nxënë.
- Për të forcuar më tej përpjekjet për qasje dixhitale, DIIT do të përditësojë kërkesat për propozime duke sqaruar pritshmëritë për qasjen dixhitale dhe duke e bërë të detyrueshme që të gjithë zhvilluesit përkatës nga ana e kompanive partnere të përfundojnë trajnimin për qasjen.

Qasje Programore

NYCPS punon me përkushtim për të ulur pengesat dhe për të ofruar burime thelbësore për të gjithë nxënësit, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të kenë qasje të plotë në programet e tyre arsimore.

Zhvillime që nga Prilli 2024

- Në qershor 2024, NYCPS krijoi Divizionin për Mësim të Përfshirë dhe të Qasshëm (Division of Inclusive and Accessible Learning – DIAL), i cili siguron që nxënësit shumëgjuhësh, nxënësit me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre të kenë qasje të plotë në mësimdhënie, në të mësuarit dhe në jetën komunitare të shkollës.
- Për të festuar identitetet e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe për të mbështetur një kulturë përkatësie dhe komuniteti, DIAL krijoi InclusiveSchoolsNYC, një nismë aktive në mbi 90 shkolla në të gjithë qytetin që ofron evente rreth komunitetit, programe, burime dhe klube të drejtuara nga vetë nxënësit.
- Në prill 2025, DIAL nisi Samitin e Nxënësve për Arsimin Përfshirës (Inclusive Education Student Summit) — një aktivitet vjetor që bashkon nxënës me dhe pa aftësi të kufizuara për të fituar perspektiva të reja mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, për të thelluar të kuptuarit mbi qasjen dhe për të krijuar ndryshime pozitive përmes aktivizmit praktik. Gjatë këtij aktiviteti, drejtues të NYCPS dhe këshilltarë mësimorë punuan së bashku për të krijuar

plane veprimi me synimin për të zgjeruar komunitetet shkollore që janë të qasshme dhe përfshirëse.

- Përmes partneritetit me Zyrën për Rrugët e Nxënësve, DIAL ka ofruar trajnim individual dhe në grupe të vogla për mësuesit në programet e Arsimit Profesional dhe Teknik (Career and Technical Education), për t'i ndihmuar ata të ofrojnë mbështetje të përshtatur për nxënësit e shkollës së mesme me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në këto programe.
- Për të përmirësuar mundësitë për karrierë për nxënësit me aftësi të kufizuara duke i pajisur ata me aftësi të transferueshme (transferable skills), NYCPS ka zgjeruar mundësitë për mësim të bazuar në punë dhe praktika profesionale, duke ofruar mbështetje të përshtatur dhe mjedise pune të qasshme, me synim rritjen e pjesëmarrjes së tyre në dy programe të lidhura me karrierën. Nxënësit pjesëmarrës në programin Career Readiness and Modern Youth Apprenticeship (një program praktike dy deri në tre vjeçar, i paraprirë nga një kurs i thelluar mbi përgatitjen për karrierë) dhe FutureReadyNYC (një nismë shumëvjeçare e zhvilluar në partneritet me New York City Jobs Council dhe CareerWise New York) përfitojnë trajnim dhe përvojë pune për të zhvilluar më tej aftësitë dhe njohuritë në fushat profesionale që synojnë.
- Zyra për Planifikimin e Qasjes (OAP) nisi një formular të ri të thjeshtuar online për Kërkesë për Përshtatje të Arsyeshme në faqen e NYCPS, që u lejon nxënësve, familjeve dhe publikut të paraqesin kërkesa online për përshtatje të lidhura me qasjen në ndërtesa shkollore dhe aktivitete publike.
- Për të mbështetur dhe ndihmuar më mirë nxënësit me nevoja për qasje, Zyra e Shëndetit në Shkolla (Office of School Health) krijoi një aplikacion të ri online (Sistemi për Përshtatje të Nxënësve (Student Accommodation System)), që i lejon shkollat të nisin kërkesa për plane sipas Seksionit 504, të ndjekin procesin dhe të përgatisin e finalizojnë këto 504 plane për nxënësit e NYCPS.
- NYCPS gjithashtu përmirësoi dy aplikacione online: aplikacionin për Përshtatje gjatë Verës dhe Panelin për Aktivitetet Pas Shkollës dhe Ekstrakurrikulare (Summer Accommodation application and the After School and Extracurricular Dashboard), për të thjeshtuar procesin e

kërkesave për mbështetje nga asistentë personalë dhe infermierë për nxënësit me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në aktivitete jashtë orarit të mësimi, përfshirë programet pas shkollës dhe Summer Rising.

Qëllimet deri në Maj 2026

- Për aktivitetin e vitit të ardhshëm "Inclusive Education Student Summit", DIAL synon të dyfishojë afërsisht kapacitetin e regjistrimit të nxënësve.
- DIAL pret të zgjerojë ndikimin e nismës InclusiveSchoolsNYC duke ofruar programe dhe klube shtesë për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta dhe të larta në NYCPS.
- NYCPS synon të rrisë shkallën e pjesëmarrjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në programet Career Readiness and Modern Youth Apprenticeship dhe FutureReadyNYC.

Komunikimi Efektiv

NYCPS mbështet komunikimin efektiv për individët me kufizime në dëgjim, shikim apo të folur, duke ofruar pajisje dhe shërbime ndihmëse për të mbështetur komunikimin me mësuesit dhe bashkëmoshatarët, kryerjen e detyrave shkollore dhe pjesëmarrjen në programe dhe aktivitete shkollore. Përveç kësaj, NYCPS vendos rregullore, udhëzime dhe programe trajnimi që rrisin ndërgjegjësimin për qasjen mes stafit dhe promovojnë praktika të komunikimit që përshijnë personat me aftësi të kufizuara.

Zhvillime që nga Prilli 2024

- DIIT organizoi tre seanca trajnimi në shkallë të gjerë për zhvillues dhe ofrues shërbimesh mbi përputhshmërinë e faqeve të internetit me standardet e qasjes.
- Për të promovuar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe ndërgjegjësimin përmes fuqisë së filmit, NYCPS krijoi një partneritet me ReelAbilities Film Festival, festivali më i madh në Shtetet e Bashkuara i përkushtuar për të nxjerrë në pah jetën, historitë dhe shprehjen artistike të personave me aftësi të kufizuara. Ky bashkëpunim synon të integrojë përmbajtje të lidhura me aftësinë e kufizuar në përvojën mësimore të nxënësve në të gjitha nivelet (nga

Kopshti deri në klasën e 12-të). Përmes këtij partneriteti, çdo mësues i NYCPS do të ketë qasje të pakufizuar në një koleksion të gjerë filmash të krijuar nga dhe për persona me aftësi të kufizuara.

- NYCPS zhvilloi tabela komunikuese për të mbështetur nxënësit e përfshirë në programin AIMS, një program edukimi të hershëm për nxënës autikë që kanë nevoja të theksuara për mbështetje në fushat e përgatitjes për të mësuar, gjuhës, komunikimit, aktiviteteve të përditshme dhe sjelljes. Në një projekt pilot, tabela komunikuese të personalizuar u vendosën në pesë ndërtesa shkollore nëpër qytet, me simbole për shkronja, numra dhe ikona të posaçme të programit të shoqëruara me etiketa përkatëse, me qëllim lehtësimin e komunikimit ndërmjet nxënësve të AIMS, bashkëmoshatarëve dhe stafit.
- NYCPS u ofroi shkollave qasje në Read&Write, një shirit mjetesh për qasje dixhitale që është i përshtatshëm për të gjitha platformat digjitale dhe përfshin funksione si: shkrim me diktim, lexim me zë, parashikim fjalësh, fjalor vizual dhe përkthim në mbi 90 gjuhë.

Qëllimet deri në Maj 2026

- Ekipi Qendror për Teknologji Ndhmëse do të promovojë ndërgjegjësimin dhe përdorimin e gjerë të teknologjisë Read&Write përmes kanaleve të ndryshme, përfshirë seanca informuese dhe module trajnimi.

Përfshirja në Vendin e Punës

Zhvillime që nga Prilli 2024

- Gjatë verës së vitit 2024, Dikasteri i Burimeve Njerëzore nisi një buletin mujor për të gjithë punonjësit. Për të rritur ndërgjegjësimin dhe mbështetjen për qasjen në vendin e punës, Zyra për Përshtatjet për Aftësi të Kufizuara (Office of Disability Accommodations – ODA) siguroi që buletini i shtatorit 2024 të përfshinte informacion për të gjithë punonjësit mbi procesin e kërkesave për përshtatje, përfshirë se si mund të bëjnë një kërkesë. Buletini mujor publikoi gjithashtu përditësime mbi përshtatjet që lidhen me Aktin për Barazi për Punonjëset Shtatzënë (Pregnant Workers Fairness Act – PWFA).
- Përmes pjesëmarrjes së saj në programin Partneritet për Praktika të Përfshirëse (Partnership for Inclusive Internships – PII), një partneritet publik-privat i financuar me grante midis AHRC New York City dhe

agjencive të qeverisë lokale dhe shtetërore të Nju Jorkut për të mbështetur punësimin e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet praktikave në administratën publike, NYCPS priti nëntë praktikantë PII, njëri prej të cilëve u punësua me kohë të plotë.

Qëllimet deri në Maj 2026

- Zyra për Përshtatje për Aftësi të Kufizuara (ODA) do të vazhdojë të publikojë njoftime të përgjithshme për përshtatjet dy herë në vit për të gjithë punonjësit, si dhe çdo përditësim të rëndësishëm, duke siguruar komunikim të vazhdueshëm dhe mbështetje të vazhdueshme për qasjen.
- ODA planifikon të publikojë një memorandum të përditësuar për personelin në lidhje me përshtatjet në vendin e punës, për të pasqyruar ndryshimet e fundit në ligje dhe procese, përfshirë dispozitat e reja për Aktin për Barazi për Punonjëset Shtatzënë (PWFA).
- NYCPS synon të rrisë pjesëmarrjen në programin PII duke pritur më shumë praktikantë në vitet në vijim.

Konsultime dhe Komente nga Publiku

Përpara publikimit të planit pesëvjeçar të qasjes 2024–2028, një draft paraprak u publikua në faqen e internetit të NYCPS në dhjetor 2023 dhe u hap për komente nga publiku. Gjithashtu, MOPD postoi planin e propozuar dhe një njoftim për mundësinë për të dhënë komente në faqen e dedikuar për Planet e Qasjes së Agjencive të Qytetit të Nju Jorkut.

NYCPS bashkëpunon aktivisht me organizata që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për të zhvilluar objektiva dhe politika në planifikimin kapital që mbështesin këtë komunitet. Agjencia mban takime të rregullta me këto organizata, duke siguruar që sugjerimet e tyre të vlefshme të pasqyrohen në planet dhe veprimet institucionale.

Përfundime

NYCPS mbetet plotësisht e përkushtuar për të siguruar që programet, shërbimet dhe aktivitetet e saj të jenë të qasshme për stafin, nxënësit, familjet dhe anëtarët e komunitetit. Ky raport përparimi tregon qartë se NYCPS po avancon në mënyrë aktive një sërë procesesh që mbështesin personat me aftësi të kufizuara, duke vazhduar punën për eliminimin e pengesave dhe ndërtimin e një mjedisi të përfshirës.